



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

NJOFTIM PËR SHPREHJE INTERESI

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, fton të gjithë të interesuarit të cilët përmbushin kriteret e përgjithshme dhe preferenciale, të detajuara në këtë shpallje, për pozicionin vakant të **Drejtorit Ekzekutiv të Autoritetit të Aviacionit Civil** të shprehin interesin e tyre brenda datës 29 Tetor 2017.

Përshkrimi i Punës:

Në bazë të Ligjit Nr. 10233/2010, “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, i ndryshuar, Neni 13, Drejtori Ekzekutiv i AAC ka këto përgjegjësi e detyra:

- a) është përgjegjës për drejtimin dhe administrimin e veprimtarisë së Autoritetit;
- b) paraqet për miratim në këshillin drejtues rregulloren e brendshme të funksionimit të Autoritetit;
- c) paraqet për miratim në këshillin drejtues buxhetin dhe programin përkatës të punës përpara fillimit të çdo veprimtarie;
- ç) harton dhe paraqet për miratim në këshillin drejtues programin ekonomiko-financiar të Autoritetit, si dhe vlerat e tarifave që do të zbatohen për të gjitha autorizimet, certifikimet dhe licencat që lëshon ky Autoritet;
- d) përfaqëson Autoritetin në marrëdhëniet me të tretët;
- dh) ushtron të gjitha detyrat e Autoritetit, në zbatim të Kodit Ajror dhe nënshkruan të gjitha autorizimet, lejet, licencat e kategorizimet.

Gjithashtu, përvec përgjegjësive dhe detyrave të paraqitura më sipër, Drejtori Ekzekutiv duhet të ndjek dhe zbatojë objektivat e Programit të Qeverisë 2017-2021, sa i përket përfshirjes në zhvillimin e infrastrukturës së re aeroportuale në vend, plotësimin e detyrave integruese të këtij sektorit dhe sjelljen në standard ndërkombëtar të institucionit të Autoritetit të Aviacionit Civil.

Kriteret e Përgjithshme:

Me qëllim përmbushjen me sukses të përgjegjësive dhe detyrave të detajuara më sipër, **kandidatët e interesuar në këtë pozicion pune duhet të përmbushin kriteret e përgjithshme**, sipas Nenit 14 të Ligjit Nr. 10233/2010, “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, i ndryshuar, si më poshtë:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë arsim të lartë;
- c) të ketë përvojë, të paktën 5 vjet, në administratën publike në fushën e menaxhimit, administrimit dhe të jurisprudencës;
- ç) të ketë integritet moral dhe profesional;
- d) të jetë i paangazhuar në funksione drejtuese partiake;
- dh) të mos jetë dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për vepra penale;
- e) të mos jetë përjashtuar nga shërbimi civil;
- ë) të mos ketë konflikt interesash me detyrën, në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi.

Kriteret që Preferohen:

Me qëllim përmbushjen me sukses edhe të sfidave të sektorit sipas Programit të Qeverisë 2017-2021, **kandidatët preferohen të përmbushin kriteret si më poshtë:**

- Të kenë kryer studimet e larta në fushën e aviacionit civil
- Të kenë eksperiencë në fushën e aviacionit civil, në sektorin publik dhe/ose privat
- Të kenë eksperiencë minimale 3 vjecare në nivel drejtues, në sektorin publik dhe/ose privat
- Të kenë njohje të mirë të legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e aviacionit civil
- Të kenë eksperiencë në manaxhimin e projekteve infrastrukturore komplekse në sektorin publik dhe/ose privat
- Të kenë aftësi negociuese të kontratave komplekse infrastrukturore në sektorin publik dhe/ose privat
- Të kenë aftësi të provuara manaxheriale dhe lidhshme në pozicione të mëparshme

Mënyra e Vlerësimit të Kandidatëve:

Ndarja e pikëve të vlerësimit të kandidatëve do të jetë si më poshtë:

Kriteri	Pikët
<i>Kriteret e Përgjithshme</i>	1
<i>Kritere Preferenciale:</i>	
Studime në fushën e aviacionit civil	0.5
Eksperiencë punë në fushën e aviacionit civil	0.5
Njohje të legjislacionit në fushën e aviacionit civil	0.5
Eksperiencë pune 3 vjecare në nivel drejtues	1
Eksperiencë në manaxhimin e projekteve infrastrukturore komplekse	1
Aftësi negociuese të kontratave infrastrukturore komplekse	1
Aftësi manaxheriale dhe lidhësi	0.5
TOTALI PIKËVE	6 PIKË

Për sa më sipër, të gjithë të interesuarit që plotësojnë kriteret e mësipërme janë të lutur të depozitojnë dokumentacionin e nevojshëm pranë MIE dhe/ose elektornikisht në adresën sekretaria@infrastruktura.gov.al, si më poshtë:

- CV
- Dëshmi Penalitetit, jo më të vjetër sesa 3 muaj
- Kopje të diplomave të shkollës së lartë dhe/ose certifikata trajnimesh

brenda datës 29 Tetor 2017.

Për kandidatët që plotësojnë kriteret e mësipërme, do të kontaktohen nga MIE për të vijuar në fazën e intervistave pranë këtij institucioni.